



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1396 Prot.

Tiranë, më 07.11 2019

VENDIM Nr. 233, datë 31.10.2019

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, Neni 134, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 12, datë 31.10.2019, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të *projektit "Pikë furnizimi me karburant dhe ambiente shërbimi" Sautk Tiranë*- subjekti "AL OIL 2019"sh.p.k., realizuar nga subjekti i licencuar në arkeologji Z. Taulant Rama,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të *projektit "Pikë furnizimi me karburant dhe ambiente shërbimi" Sautk Tiranë*- subjekti "AL OIL 2019"sh.p.k., realizuar nga subjekti i licencuar në arkeologji Z. Taulant Rama.
2. Subjekti "AL OIL 2019"sh.p.k, duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin *"Pikë furnizimi me karburant dhe ambiente shërbimi"*, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, cila do të mbikëqyrë këtë subjekt.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al